



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3096/ 11prot.

Datë 05.02.2025

V E N D I M
Nr. 186/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.02.2025 me

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “I-Fire” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-20976-09-20-2024, me objekt: “Riparim mirëmbajtje e sistemit hidro-mekaniko-elektrik të MZSH dhe rimbushje e kolaudimin e fikësve të zjarrit në godinat spitalore të QSUNT”, për 24 muaj me fond limit 7,106,366.67 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 03-10-2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare Nene Tereza Tirane.

Ankimues:

“MBROJTJA DHE SHPËTIMI NGA ZJARRI” SHPK me L62102007V dhe adresë Rruga “Artan Lenja”, Hyrja Nr.1, Zonë Kadastrale Nr.8210, Nr.Pasurie 1/301-N3, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Qendra Spitalore Universitare Nene Tereza Tiranë,
Adrese: “Rruga e Dibrës” Nr. 372, Tiranë.

Subjekte të Interesuara:

“I-Fire” SHPK me NIPT, L71921002H dhe adresë: Tirane, “Rruga Kavajës”, Pallati nr.4, Dyqani nr.9, Pranë Shkollës Teknologjike, ZK 8260, nr Pasurie 1/301, Tiranë.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë

19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomikë ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomikë ankimues, ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 23-09-2024 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-20976-09-20-2024, me objekt: “Riparim mirëmbajtje e sistemit hidro-mekaniko-elektrik të MZSH dhe rimbushje e kolaudimin e fikësve të zjarrit në godinat spitalore të QSUNT”, për 24 muaj me fond limit 7,106,366.67 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 03-10-2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare Nene Tereza Tiranë.

II.2. Në datën 03-10-2024, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor më datë 16.10.2024 , ka kryer rivlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1.I-Fire SHPK	5.365.300 lekë	kualifikuar
2.Erjon Saraci pf	5.628.750 leke	Skualifikuar
3.Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri SHPK	6.879.600 lekë	kualifikuar

II.4 Në datën 18.10.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, Njoftimi i fituesit Paraprak, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në datën 24.10.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi Elektronik me nr. A/2024/4707 si dhe nr. Protokoli 3096/2024 datë 24.10.2024, i operatorit ekonomik “MBROJTJA DHE SHPËTIMI NGA ZJARRI” SHPK lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “I-Fire” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 3096/2 prot., datë 25.10.2024 lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “I-Fire” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.7 Në datën 10.12.2024 Komisioni Prokurimit Publik ju drejtua autoritetit Kontraktor Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë, me shkresën me Nr 3096/3 me lëndë “ Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” SHPK” .

II.8 Në datën 13.01.2025 Komisioni Prokurimit Publik ju drejtua me rikërkesë autoritetit Kontraktor, Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë, me shkresën me Nr 3096/4, “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” SHPK”.

II.9. Autoriteti kontraktor, me shkresën nr. 203/2 prot., datë 15.01.2025 protokolluar me tonën me nr.3096/5 prot., datë 16.01.2025 ka dërguar vendimin e KSHA, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Mbrotja dhe Shpëtimi nga Zjarri”

SHPK. Referuar vendimit të KSHA, rezulton, se KSHA ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues te sipërcituar.

II.10 Autoriteti kontraktor, me shkresën nr. 203/3 prot., datë 15.01.2025 protokolluar me tonën me nr.3096/6 prot., datë 17.01.2025 ka dërguar vendimin e KSHA, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues” Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” SHPK. Referuar vendimit të KSHA, rezulton, se KSHA ka vendosur mos pranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues te sipërcituar dhe dokumentacionin e operatorit ekonomik “I-Fire” SHPK te dorëzuar pranë Autoritetit Kontraktor.

III.11 Në datën 22.01.2025 Komisioni Prokurimit Publik dërgoi shkresën me lëndë “Kërkesë për informacion”, drejtuar operatorit ekonomik “I-Fire” SHPK, me përmbajtje “Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të nevojshme të kërkojë nga ana juaj paraqitjen e skedave teknike të dorëzuar në SPE, në përmbushje të specifikimeve teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, ku të evidentoni qartë (markoni)/(nënvizoni) përmbushjen e specifikimeve teknike bashkë me një përshkrim të saktë në skedën teknike të ngarkuar nga ana juaj në SPE.

Sa më sipër, në zbatim të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Komisioni i Prokurimit Publik kërkon nga ana juaj, dërgimin e informacionit të kërkuar për sa më lart, brenda datës 27.01.2025.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të një përgjigje sa më të shpejtë nga ana juaj.”

II.12 Në datën 30.01.2025 Agjencia e Prokurimit Publik dërgon shkresën me nr 911/1 me lëndë shkresë përcjellëse protokolluar me tonën Nr. 3096/8 datë 31.01.2025 ku citohet se “Pranë Agjencisë së Prokurimit Publik (në vijim "APP") është depozituar shkresa datë 27.01.2025 (protokolluar në institucion me Nr. 911 Prot., datë 28.01.2025) dërguar nga operatori ekonomik "I-Fire" shpk me objekt: "Kthim përgjigje". Nga shqyrtimi i kësaj shkresë rezulton se i është drejtuar institucionit tuaj, pra rezulton të ketë ardhur gabimisht në APP. Neni 24, pika 1, i Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë" parashikon që: "Kur një organ publik merr një kërkesë, për një çështje që e vlerëson jashtë kompetencës së vet, ia përcjell kërkesën menjëherë, dhe në çdo rast jo më vonë se dy ditë nga marrja e saj, organit publik kompetent dhe njofton kërkuuesin për këtë". Sa më sipër, bashkëlidhur po ju dërgojmë shkresën e sipërcituar, drejtuar institucionit tuaj. Duke ju falënderuar për bashkëpunimin”

Bashkëlidhur kësaj shkresë dokumentacion dhe narrativ i operatorit ekonomik “I-Fire” SHPK date 27.01.2025.

II 13.Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente

në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e parë në ankesë, të operatorit ekonomik ankimes me argumentimin se *“Shoqëria jonë ka dyshime të arsyeshme se kriteri i sipërcituar nuk përmbushet nga operatori ekonomik, pasi mungojnë vërtetimet e lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës. Duke e njohur kapacitetin e operatorit ekonomik i cili nuk ka kontrata dhe vërtetime realizimi me sukses, kemi bindjen që pranë autoritetit kontraktor ka dorëzuar vetëm fatura. Sa më sipër autoriteti kontraktor duhej të skualifikonte ofertën e operatorit ekonomik I-FIRE shpk Komisioni Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në shtojcën 8 *“Kriteret e veçanta të kualifikimit”*, pika 2.3. *“Kapaciteti teknik”*, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Kapaciteti teknik:

a) Dëshmi nga operatori ekonomik për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë **jo më e vogël 20% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, kërkohen **vërtetime të lëshuara nga një autoritet / ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës së bashku me kontratën e lidhur dhe / ose fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, **ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.**

Shënim*: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, shuma e mësipërme do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar për këtë procedurë prokurimi, konkretisht mbi vlerat e kolonës **“Vlera e pritshme e kontratave”** në pikën 2.10 të njoftimit të kontratës.

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik ankimes “I-Fire” SHPK, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

Fature me Nr. 155 date 03.06.2024 me vlere totale X midis “i-Fire” shpk dhe “Olsi” shpk

Fature me Nr. 746 date 04.12.2023 me vlere totale X midis "i-Fire" shpk dhe Dega "Renco"
SPA ALBANIA
Fature me Nr 491 date 05.09.2023 me vlere totale X midis "i-Fire" shpk dhe Dega "Renco"
SPA ALBANIA

III.1.3. Në nenin 2 "Qëllimi i ligjit" të ligjit nr. 162/2021 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në nenin 3 "Parime të përgjithshme" të ligjit nr. 162/2021 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktorë garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktorë nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktorë janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktorë përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktorë mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktorë, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: "3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji..."

III.1.4. Neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimit të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit”.

III.1.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.6. Referuar sa më sipër, Komisioni konstaton, se në dokumentet e tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor në lidhje me vërtetimin e përvojës së ngjashme ka kërkuar që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të paraqesin dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit për të cilin ata konkurrojnë, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël Dëshmi nga operatori ekonomik për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë **jo më e vogël 20% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.** KPP gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të dëshmimeve të eksperiencës së ngjashme të dorëzuar nga ana e operatori ekonomik ankimues, parë kjo në rrafshin krahasimor me kërkesat teknike të autoritetit kontraktor, natyrës së procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Kështu, referuar shtojcës mbi specifikimet teknike të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar shërbimin objekt - prokurimi. KPP gjykon, se në rastin konkret, kërkesa e autoritetit kontraktor referuar objektit të procedurës së prokurimit, lidhet me blerjen e shërbimit Rimbushës Fikës Zjarri.

Në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar është parashikuar se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktorë mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktorë, në veçanti, mund të kërkojnë që

operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”. KPP vlerëson se së pari, norma juridike duhet të interpretohet e më pas të gjykohet, kjo për të analizuar në thelb *ratio legis*, kuptimin e drejtë të saj. Kështu, ligjvënësi ka parashikuar diskrecionin e autoritetit kontraktor të kërimit të dëshmive për përvojën e mëparshme, me synim për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Pra, e drejta e dhënë nga ligji lidhet ngushtësisht me garantimin e autoritetit kontraktor, se operatori ekonomik disponon dëshmi të përvojës së mëparshme për të realizuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Gjithashtu, me akt nënligjor, diskrecioni i vendosur nga ligji është rregulluar edhe më tej, ku në rastin e kontratave për mallra, ligjvënësi në nenin 40, pika 4 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ka parashikuar, se ky kriter në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me entet publike, mund të përmbushet me dorëzimin e vërtetimeve të lëshuara nga enti publik ose me paraqitjen e faturës tatimore të shitjes, ku vërtetohet realizimi me sukses i një ose disa kontratave të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të madhe se 40 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe në rastin e përvojës së ngjashme të mëparshme të realizuar me sektorin privat mund të përmbushet me dorëzimin e faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe furnizimet e realizuara, ku të vërtetohet realizimi i furnizimeve të ngjashme gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të madhe se 40% e vlerës së kontratës që prokurohet. Gjithashtu, në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar se plotësimi i njërit prej dy kushteve e bën ofertën të kualifikueshme. Duke iu kthyer kriterit, KPP konstaton, se kriteri i hartuar nga ana e autoritetit kontraktor është në përputhje me diskrecionin e dhënë nga ligji dhe akti nënligjor, si edhe afati i kërimit të dokumentacionit është brenda periudhës trevjeçare sikundër parashikohet edhe në këtë Vendim të Këshillit të Ministrave. Lidhur me faktin se operatori ekonomik “I-Fire” shpk nuk ka plotësuar pikën a) të kriterit 2.3.1, KPP vlerëson se lidhur me këtë kërkesë vetë legjislacioni i sipërcituar përkatësisht ai i VKM Nr. VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: ne nenin 41 lidhur me kërkesën mbi përvojën e mëparshme për shërbim citohet se:

3. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit”.

Pra siç vërehet qartë nuk është e detyrueshme nga ligji disponimi si i kontratave nga ente publike ashtu dhe faturave tatimore në sektorin privat.

Kriteri i përcaktuar konsiderohet i përmbushur vetëm me plotësimin e njërës prej mënyrave të përcaktuara nga Ligji i Prokurimit Publik, referuar kësaj te fundit dhe kriterit të përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor lidhur me shërbimet të ngjashme konstatohet se operatori ekonomik "I-Fire" shpk në përmbushje të kriterit të sipërcituar ka ngarkuar në SPE dokumentacionin e nevojshëm, *Faturë me Nr. 155, datë 03.06.2024, me vlerë totale X midis "i-Fire" shpk dhe "Olsi" shpk.*

Faturë me Nr. 746, datë 04.12.2023, me vlerë totale X midis "i-Fire" shpk dhe "Dega Renco" SPA ALBANIA.

Faturë me Nr. 491, datë 05.09.2023, me vlerë totale X midis "i-Fire" shpk dhe "Dega Renco" SPA ALBANIA.

Në këtë kuptim, KPP gjykon, se operatori ekonomik "I-Fire" shpk me dokumentacionin e paraqitur, provon se ka kryer furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit, duke plotësuar kështu kërkesën për kualifikim, për përvojë të suksesshme përcaktuar në pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri" SHPK mbi kualifikimin e operatorit ekonomik "I-Fire" shpk me pretendimin se *"Duke njohur kapacitetet e operatorit ekonomik "I-FIRE" shpk, jemi të bindur që në stafin e tyre nuk kanë asnjë punonjës me profilin "Hidrik" ose "Mekanik" dhe nuk kanë dorëzuar asnjë dokumentacion mbi të cilin vërtetohet profili i punonjësit. [...]* Komisioni Prokurimit Publik vëren:

III.2.1 Në pikën 2.3. të shtojcës 8 "Formular i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit", të dokumenteve të tenderit autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

- a) Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf për kryerjen e shërbimit, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, me dokument certifikues (*diplomë dhe/ose dëshmi kualifikimi*), për profilin profesional të kërkuar, lëshuar nga institucione publike apo private të akredituara për certifikimin e punonjësve sipas legjislacionit në fuqi, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:
- 2 punonjës për shërbimin e mirëmbajtjes së pajisjeve kundër zjarrit.
 - 1 punonjës hidrik /ose/ mekanik për shërbimin e mirëmbajtjes të sistemit të MZSH-së nga elektropompat deri tek hidrante.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

III.2.2 Në seksioni B: DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen), të shtojcës 10 "Formulari Përmbledhës i vetëdeklarimit", autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
-----------	-----------

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: Profili i punonjësve <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:
	Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak dhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.
- Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

- Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për dokumentet e ofertës të ngarkuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik duhet të dorëzojë dokumentet provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara. Ndërsa, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.
- Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe/ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

III.2.3 Referuar shkresës me nr. 203/3 prot., datë 15.01.2025, protokolluar me tonën me nr. 3096/6 prot., datë 17.01.2025 të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” rezulton se në përmbushje të pikës 2.3.b të shtojcës 8 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, për mjetin e kërkuar operatori ekonomik “I-Fire” shpk ka dorëzuar dokumentacion si vijon:

- Formular Përmbledhës Vetëdeklarimi; ku ka cituar personin E.Z si punonjës hidrik për shërbimin e mirëmbajtjes së sistemit të MZSHH nga elektropompat deri tek hidrantët i trajtuar dhe i certifikuar.
- Vërtetim njësie me origjinalin me nr 20306 rep., datë 30.09.2024 me përmbajtje, Certifikatë Nr. C08642024 lëshuar ne emër të E.Z .
- Certifikatë lëshuar nga “Certis” në emër të Z. E.Z për trajnimin dhe testimin përfundimtar për profesionin Hidraulik Sistemet Hidro-Mekanike me Nr. certifikate C08642024 me date lëshimi 01 gusht 2024.
- Kontrate individuale pune lidhur me datë 05.04.2023 midis “I-Fire” shpk dhe E.Z me proferion Teknik Investigues Zjarri.
- Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore, dhe Tatimit mbi të ardhurat nga punësimi për muajin gusht 2024.
- Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore, dhe Tatimit mbi të ardhurat nga punësimi për muajin shtator 2024.

III.2.4. Në nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet*

ndërmjet aktivit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”.

III.2.5 Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla. 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon: a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv; 13 b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është

parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi; d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi; dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së; e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohej për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës; g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor; h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti); i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti; k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi; l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi; ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. 3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash. 4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohej të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente. 14 6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në procedurat e prokurimit me fazë, ky dokumentacion i kërkohej të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Për dokumentat e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t’i paraqesë këto dokumenta në origjinal ose të njehsuara me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njehsuara me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur. 7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”

III.2.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.7. Konkretisht, referuar kriterit në lidhje me disponimin e mjeteve (autolaborator profesional tipi kombinat), të kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka përcaktuar se, këto kërkesa do të përmbushen nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar. Referuar dokumentacionit të ndodhur në fashikullin administrativ rezulton se me shkresën nr. 3096/6 prot., datë 17.01.2025, protokolluar pranë autoritetit kontraktor me nr. 2023/3prot., datë 15.01.2025 operatori ekonomik ka dorëzuar dokumentacionin në përmbushje të pikës 6 të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar

Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues ndaj operatorit ekonomik “I-Fire” shpk se: *“Por duke njohur kapacitetet e operatorit ekonomik “I-FIRE” shpk, jemi të bindur që në stafin e tyre nuk kanë asnjë punonjës me profilin Hidrik ose Mekanik dhe nuk kane dorëzuar asnjë dokumentacion mbi të cilin vërtetohet profili i punonjësit”*. KPP vëren se lidhur me këtë të fundit është paraqitur dokumentacioni i kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Operatori ekonomik ka cituar si në formularin e Vetëdeklarimit si hap fillestar kualifikimi dhe më pas në formë shkresore dokumentacionin e duhur në bazë të kërkesës së autoritetit kontraktor, për verifikimin e punonjësve duke depozituar pranë AK dokumentacionin: Formular Përmbledhës Vetëdeklarimi; ku ka cituar personin E.Z si punonjës hidrik për shërbimin e mirëmbajtjes së sistemit të MZSHS nga elektropompat deri tek hidrantët i trajtuar dhe i certifikuar.

-Vërtetim njësie me origjinalin me nr. 20306 rep. datë 30.09.2024 me përmbajtje, certifikatë Nr. C08642024 lëshuar në emër të E.Z.

-Certifikatë lëshuar nga “Certis” në emër të Z. E.Z per trajnimin dhe testimin përfundimtar për profesionin Hidraulik Sistemet Hidro-Mekanike me Nr. certifikate C08642024 me date lëshimi 01 gusht 2024.

-Kontrate individuale pune lidhur me datë 05.04.2023 midis “I-Fire” shpk dhe E.Z me profesion Teknik Investigues Zjarri.

-Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore, dhe Tatimit mbi te ardhurat nga Punësimi për muajin gusht 2024.

-Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore, dhe Tatimit mbi te ardhurat nga Punësimi për muajin shtator 2024.

Pra, referuar kriterit të sipërcituar ku autoriteti kontraktor kërkon në pikën 2.3. b): **Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf për kryerjen e shërbimit, të vërtetuar me kontratë punë të vlefshme, me dokument certifikues (diplomë dhe/ose dëshmi kualifikimi), për profilin profesional të kërkuar, lëshuar nga institucione publike apo private të akredituara për certifikimin e punonjësve sipas legjislacionit në fuqi, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë: 1 Punonjës hidrik /ose/ mekanik për shërbimin e mirëmbajtjes të sistemit të MZSH-së nga elektropompat deri tek hidrante**, KPP gjykon se operatori ekonomik e përmbush kriterin e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor lidhur me punonjësën e deklaruar dhe me dokumentacionin e depozituar pranë Autoriteti Kontraktor në përmbushje të Formularit të Vetedeklarimit dhe kriterit të përcaktuar nga AK.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Mbrotja dhe Shpëtimi nga Zjarri” shpk mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “I-Fire” shpk me pretendimin se:

[...] “Operatori ekonomik “I-Fire” shpk nuk ka dorëzuar autorizim prodhuesi/distributori për produktin Gaz FM-200, pasi kompanitë prodhuese të këtij produkti nuk kanë asnjë distributor për territorin e Republikës së Shqipërisë, por mund të autorizojnë drejtpërdrejtë. Gjithashtu për produktin FM-200 janë shumë pak kompani prodhuese me të cilat ne kemi raporte dhe nuk na është dhënë asnjë informacion mbi këtë autorizim të mundshëm. Sa më sipër kërkojmë verifikimin e këtij autorizimi nëse është dorëzuar.

-Lidhur me pikën më sipër mbi autorizimin e produktit FM-200, rrjedhimisht edhe skedat teknike apo katalogët për këtë produkt nuk mund të përputhen me kompaninë prodhuese. Komisioni prokurimit Publik vëren se:

III.3.1 Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar kriterin lidhur me pretendimin e mësipërm në pikën 2.3 dh) si më poshtë vijon:

dh) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim nga firma prodhuese/distributori i autorizuar i prodhuesit, (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) për mallrat Pluhur ABC 40%, Shkumë AFFF (6%), Gaz FM-200, CO2. Autorizimi duhet të jetë origjinal dhe nëse nuk është në gjuhën shqipe, të përkthehet në gjuhën shqipe dhe të noterizohet.

III.3.2 Me dokumentacionin e dorëzuar pranë AK të operatorit ekonomik “I-Fire” shpk dhe më pas depozituar pranë KPP me nr. prot 203/3 datë 15.01.2025, protokolluar me tonën Nr. 3096/6 datë 17.01.2025 operatori ekonomik në përmbushje të kriterit të sipërcituar ka depozituar dokumentacionin me emërtime:

-Vërtetim Njësie me Origjinalin nr. 20303 rep datë 30.09.2024 me objekt- Autorizim në gjuhën angleze e përkthyer nga përkthyesi i licensuar S.SH bashkëlidhur vërtetim përkthimi me Nr. ep 20302.

-Autorizim në gjuhën angleze e përkthyer gjithashtu në shqip ku citohet se: *Drejtuar nga: Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë, për procedurën me objektin e prokurimit: "Riparimi dhe mirëmbajtja e sistemit hidro-mekanik-elektrike të MSH-së dhe rimbushja dhe kolaudimi i aparateve zjarrrfikëse në godinat spitalore të QSUNT", për 24 muaj. Numri i tenderit: REF-20976-09-20-2024 me të cilin në: AFMER Kimya A.Ş. Incorporated Co Kestel-Bursa/Turqi.*

Ne deklarojmë se: "i-FIRE" shpk, me (NUIS) L71921002H, me adresë në Tiranë, "Rruga Kavajes", pallati me shigjeta, Dyqani nr. 9, furnizohet nga ne për materialet që prodhojmë: pluhur (40%) dhe shkumë (6%), dioksid karboni (CO₂), FM-200 (HFC 227ea). Si prodhues i autorizuar i këtyre produkteve, ne deklarojmë se subjekti "I-Fire" shpk është klienti ynë. Kjo deklaratë jepet për procedurën objekt prokurimi: siroemit hidro-mekanik-elektrik të MSH-së dhe rimbushja dhe kolaudimi i aparateve zjarrotheran e godinat spitalore të QSUNT", për 24 REF-20976-09-20-2024 për autoritetin kontraktor: Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë.

Ps. Ky autorizim mbetet i vlefshëm edhe në rast të ndryshimit të datës së tenderit

-Vërtetim përkthimi me nr. rep 20302 datë 30.09.2024.

-Kërkesë për sqarim nga përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor drejtuar operatorit ekonomik "I-Fire" shpk me përmbajtje "Në kuadër të ankesës së ardhur në sistemin Kpp.al me nr.A/2024/4707, datë 2024-10-24 dhe me nr. 3096/2024prot. për procedurën "Riparim mirëmbajtje e sistemit hidro-mekanik-elektrik dhe rimbushje e kolaudimit të fikësve të zjarrit në godinat spitalore të QSUNT", për 2 muaj kërkojmë nga ana juaj sqarim përsa i përket skedave teknike për artikujt e mëposhtëm:

1. "Pluhur ABC" skeda teknike i korrespondon shoqërisë ECOCHMMACH JSC
2. "FM-200" skeda teknike i korrespondon shoqërisë INNER MONGOLIA YOUNGHE FLUOROCHEMICAL CO LTD

Të dy këto artikuj kane orgjinë të ndryshme nga prodhuesi që ju keni paraqitur autorizim "AFMER KIMYA A.S Incorporated CO.

-Kthim përgjigje në formë komunikimi Elektronik, nga operatori ekonomik "I-Fire" shpk drejtuar përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktor me përmbajtje "Përshëndetje, duke iu referuar kërkesës suaj për sqarim në lidhje me skedat teknike të artrame "Pluhur ABC" dhe "FM-200", skedat teknike që ne kemi paraqitur janë skeda terta cilat na i ka ofruar kompania: "Afmer Kimya", prej të cilës ne blejmë dhe këto produkte. Këtë gjë mund ta vërtetojmë dhe nëpërmjet deklaratës që kompania Afmer Kimya ka bërë, ku ka shpjeguar dhe specifikisht arsyen pse këto skeda i përkasin shoqërive të tjera. Bashkëlidhur gjeni dhe deklaratën" Bashkëlidhur Deklarate PDF.

-Deklaratë lëshuar nga Afmer Kimya lëshuar në gjuhën angleze përkthyer në shqip me përmbajtje deklarate "Ne importojmë produkte Pluhur dhe FM-200 nga kompani të tjera si lëndë të para dhe me pas i shesim ato nën logon dhe paketimin e kompanisë sonë. Fletët e të dhënave teknike të pluhurit që korrespondon me kompaninë: "ECOCHMMACH JSC" dhe të FM-200 që korrespondon me kompaninë "INNER MONGOLIA YOUNGHE FLUOROCHEMICAL CO LTD" janë fletët e të dhënave teknike të paraqitura nga prodhuesi i lëndës së parë për këtë arsye fletët e të dhënave teknike korrespondojnë me kompani të tjera dhe jo me kompaninë tone.

Këto flete të dhëna teknike të prodhuesve janë paraqitur nga kompania jonë për çdo shitje që ne kemi bërë të këtyre 2 produkteve.

Këto produkte kur vijnë të distributori jonë i autorizuar “i-Fire” Shpk vijnë të paketuara nën logon tonë “Afmer Kimya”. Nënshkruar dhe vulosur nga drejtori i përgjithshëm i kompanisë. Përkthimi i Vulosur dhe nënshkruar nga përkthyesi zyrtar Saimir Shefa.

-Vërtetim përkthimi me nr 24734 datë 25.11.2024.

-Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor ku dërgon një komunikim elektronik e-mail Afmer Kimya mbi një kërkesë për sqarim në gjuhën angleze.

-Kthim përgjigje nga Kompania Afmer Kimya në gjuhën angleze në formë komunikimi elektronik email ndaj përfaqësuesit të autoritetit kontraktor.

-Vërtetim njësie me origjinalin Nr rep 20199 datë 30.09.2024 me përmbajtje “ Flete e të dhënave të sigurisë Materiale FM-200 në gjuhën angleze përkthyer nga përkthyesi i licensuar Saimir Shefa bashkëlidhur vërtetim përkthimi me nr repertori 20198

-Fletë e të dhënave të sigurisë në gjuhën angleze dhe e përkthyer në shqip, lëshuar nga Inner Mongolia Yonghe Flurochemical Co LTD për Heptafuropropan R227ea (FM-200)

-Vërtetim përkthimi Nr 20198 rep dhe datë 30.09.2024.

-Flete Zhdoganimi për produktin preparat dhe ngarkesat për zjarrfikëset ngarkesat për granatat Preparat Powder për fiksje zjarri në theksë ardhur nga Afmer Kimya në emër të marrësit I-Fire

-Faturë Financiare datë 03.10.2023

III.3.3 . Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Qëllim i këtij ligji është:*

a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.3.3 . Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe

personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.3.4. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike të produkteve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e specifikimeve të mallrave/shërbimeve të ofertuara prej tyre me ato të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me specifikimet përkatëse të kërkuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi

Përsa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues “Mbrojtja dhe SHpetimi nga Zjarri” SHPK me arsyet për skualifikim me pretendimet se “Operatori ekonomik “I-Fire” shpk nuk ka dorëzuar autorizim prodhuesi/distributori për produktin Gaz FM-200, pasi kompanitë prodhuese të këtij produkti nuk kanë asnjë distributor për territorin e Republikës së Shqipërisë, por mund të autorizojnë drejtpërdrejtë. Gjithashtu për produktin FM-200 janë shumë pak kompani prodhuese me të cilat ne kemi raporte dhe nuk na është dhënë asnjë informacion mbi

këtë autorizim të mundshëm. Sa më sipër kërkojmë verifikimin e këtij autorizimi nëse është dorëzuar”. Referuar pretendimit të sipërcituar, Komisioni konstaton, se në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar në pikën 2.3 dh) kapaciteti teknik dokumentet që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë në përmbushje të kriterit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar dhe dorëzuar nga operatori ekonomik “ I-Fire” shpk në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit, pika 2.3.dh) kapaciteti teknik. KPP konstaton, se ky i fundit, ka dorëzuar dokumentacionin [...] -Vërtetim Njësie me Origjinalin nr. 20303 rep datë 30.09.2024 me objekt- Autorizim në gjuhën angleze e përkthyer nga përkthyesi i licencuar Saimir Shefa, bashkëlidhur vërtetim përkthimi me Nr ep 20302.

-Autorizim ne gjuhen angleze e perkthyer gjithashtu ne shqip ku citohet se : *Drejtuar nga: Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë, Për procedurën me Objektin e Prokurimit: "Riparimi dhe mirëmbajtja e sistemit hidro-mekanik-elektrik të MSH-së dhe rimbushja dhe kolaudimi i aparateve zjarrfikëse në godinat spitalore të QSUNT", për 24 muaj. Numri i tenderit: REF-20976-09-20-2024 me të cilin Ne: AFMER Kimya A.Ş. Incorporated Co Kestel-Bursa/Turqi*

Ne deklarojmë se: “i-FIRE” shpk, me (NUIS) L71921002H , me adresë në Tiranë, “Rruga Kavajës”, pallati me shigjeta, Dyqani nr. 9, furnizohet nga ne për materialet që prodhojmë: pluhur (40%) dhe shkumë (6%), dioksid karboni (CO 2), FM-200 (HFC 227ea). Si prodhues i autorizuar i këtyre produkteve, ne deklarojmë se subjekti I-Fire shpk është klienti ynë. Kjo deklaratë jepet për procedurën objekt prokurimi: siroemit hidro-mekanik-elektrik te MSH-se dhe rimbushia dhe kolaudimi i aparateve zjarrotheran e godinat spitalore të QSUNT", për 24 REF-20976-09-20-2024 per autoritetin kontraktor: Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë.

Ps. Ky autorizim mbetet i vlefshëm edhe në rast të ndryshimit të datës së tenderit

-Vërtetim përkthimi Me nr rep 20302 datë 30.09.2024

-Kërkesë për sqarim nga përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor drejtuar operatorit ekonomik “I-Fire” shpk me përmbajtje “Në kuadër të ankesës së ardhur në sistemin Kpp.al me nr. A/2024/4707, datë 2024-10-24 dhe me nr. 3096/2024prot. për procedurën "Riparim mirëmbajtje e sistemit hidro-mekaniko-elektrik dhe rimbushje e kolaudimin e fikësve të zjarrit në godinat spitalore te QSUNT", për 2 muaj kërkojmë nga ana juaj sqarim përsa i përket skedave teknike për artikujt e mëposhtëm:

1. "Pluhur ABC" skeda teknike i korrespondon shoqërisë ECOCHMMACH JSC
2. "FM-200" skeda teknike i korrespondon shoqërisë INNER MONGOLIA YOUNGHE FLUOROCHEMICAL CO LTD

Të dy këto artikuj kane orgjinë te ndryshme nga prodhuesi qe ju keni paraqitur autorizim "AFMER KIMYA A.S Incorporated CO.

-Kthim përgjigje në formë komunikimi Elektronik, nga operatori ekonomik “I-Fire” shpk drejtuar përfaqësuesit te Autoritetit Kontraktor me përmbajtje “Pershendetje, duke iu referuar kërkesës suaj për sqarim në lidhje me skedat teknike të artrame "Pluhur ABC" dhe "FM-200", skedat teknike de ne kemi paraqitur janë skeda tertA cilat na i ka ofruar kompania:"Afmer Kimya", prej të cilës ne blejmë dhe këto produkte. Këtë gjë mund ta vërtetojmë dhe nëpërmjet deklaratës që kompania Afmer Kimya ka bërë, ku ka shpjeguar dhe specifikisht arsyen pse këto

skeda i përkasin shoqërive të tjera. Bashkëlidhur gjeni dhe deklaratën Bashkëlidhur Deklarate PDF.

-Deklaratë lëshuar nga Afmer Kimya lëshuar në gjuhën angleze përkthyer në shqip me përmbajtje deklarate “ Ne importojmë produkte Pluhur dhe FM-200 nga kompani të tjera si lënde të para dhe me pas i shesim ato nën logon dhe paketimin e kompanisë sonë. Fletët e të dhënave teknike të pluhurit që korrespondon me kompaninë: "ECOCHMMACH JSC" dhe te FM-200 që korrespondon me kompaninë"INNER MONGOLIA YOUNGHE FLUOROCHEMICAL CO LTD" janë fletët e të dhënave teknike te paraqitura nga prodhuesi i lendes se pare për letë arsye fletegt e te dhënave teknike korrespondojnë me kompani te tjera dhe jo me kompaninë tone.

Keto flete te dhëna teknike te prodhuese janë paraqitur nga kompania jone per cdo shitje qe ne kemi bere te këtyre 2 produkteve.

Këto produkte kur vijnë te distributori jone i autorizuar “i-Fire’ Shpk vijnë te paketuara nen logon tone “Afmer Kimya”. Nenshkruar dhe vulosur nga drejtori i përgjithshëm i kompanisë. Përkthimi i Vulosur dhe nënshkruar nga perkthyesi zyrtar Saimir Shefa.

-Vërtetim përkthimi me nr 24734 datë 25.11.2024

-Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor ku dërgon nje komunikim elektronik e-mail Afmer Kimya mbi një kërkesë për sqarim ne gjuhën angleze.

-KthimPergjifje nga Kompania Afmer Kimya ne gjuhën angleze ne forme komunikimi elektronik email ndaj përfaqësuesit te autoritetit kontraktor.

-Vërtetim njësie me origjinalin Nr rep 20199 datë 30.09.2024 me permbatje “ Flete e te dhënave te sigurisë Materiale FM-200 ne gjuhen angleze përkthyer nga përkthyesi i licensuar Saimir Shefa bashkëlidhur vërtetim përkthimi me nr repertori 20198

-Fletë e të dhënave të sigurisë në gjuhën angleze dhe e përkthyer në shqip, lëshuar nga Inner Mongolia Yonghe Flurochemical Co LTD per Heptafuopropan R227ea (FM-200)

-Vërtetim përkthimi Nr 20198 rep dhe datë 30.09.2024.

-Fletë zhdoganimi për produktin preparat dhe ngarkesat për zjarrfikëset ngarkesat për granatat Preparat Powder për fikse zjarri ne thasë ardhur nga Afmer Kimya ne emër te marrësit I-Fire

-Faturë Financiare datë 03.10.2023. Pra siç vërehet qartë operatori ekonomik lidhur me kriterin e kërkuar dhe mbi pretendimet e operatorit ekonomik animues ka dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm për përmbushjen e pikës 2.3.dh të përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit në të cilin vete kompania Afmer Kimya pra kompania qe ka lëshuar autorizim prodhuesin ka cituar se skedat teknike të ngarkuara nga “I-FIRE” SHPK dhe pse i përkasin një kompanie tjetër te cilës sipas tyre eshte kompania (Mëmë) me saktë citon se “Ne importojmë produkte Pluhur dhe FM-200 nga kompani të tjera si lënde të para dhe me pas i shesim ato nën logon dhe paketimin e kompanisë sonë. Fletët e të dhenave teknike të pluhurit që korrespondon me kompaninë: "ECOCHMMACH JSC" dhe te FM-200 që korrespondon me kompaninë "INNER MONGOLIA YOUNGHE FLUOROCHEMICAL CO LTD" janë fletët e të dhënave teknike te paraqitura nga prodhuesi i lendes se pare për këtë arsye fletët e te dhënave teknike korrespondojnë me kompani te tjera dhe jo me kompaninë tonë.

Këto fletë të dhëna teknike te prodhuese janë paraqitur nga kompania jonë për çdo shitje që ne kemi bërë të këtyre 2 produkteve.

Këto produkte kur vijnë te distributori jonë i autorizuar “i-Fire’ shpk vijnë te paketuara nen logon tone “Afmer Kimya”. Nenshkruar dhe vulosur nga drejtori i përgjithshëm i kompanisë”.

Nga analizimi i provave dhe fakteve të depozituara pranë KPP, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues, si pjesë të ofertës së tij, ka dorëzuar dokumentacione të kërkuar në dokumentet standarde të tenderit, për produktin që ka ofruar dhe që janë kërkuar të prokurohen nga ana e autoritetit kontraktor. Për sa kohë që përgjigja e ardhur në formën e një deklarate vetë Autorizim Prodhuesi qartëson faktin se lënda e parë (Mëmë) mund të prodhohet nga prodhues të tjerë, por ato e njohin si produktin e tyre me markën e “Afmer Kimya A.S Incorporated C.O”, rrjedhimisht komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor e përcaktuar në pikën 2.3.dh) kapaciteti teknik i dokumenteve standarde të tenderit, është në përputhje me produktin e kërkuar në procedurën e prokurimit objekt-prokurimi, si dhe është një kërkesë e ligjshme e në përputhje me gërmën “b”, të pikës 6 të nenit 40 të VKM 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: “Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose.

Porsa më sipër Operatori ekonomik “I-Fire” shpk me anë të dokumentacionit të paraqitur, e plotëson kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor, në pikën 2.3.dh) kapaciteti teknik i dokumenteve standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomikë ankimues “Mbrotjtja dhe Shpetimi nga Zjarri” shpk nuk qëndron.

III.4 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Mbrotjtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” shpk mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “I-Fire” shpk me pretendimin se. *Te gjitha katalogjet/skedat teknike të produkteve nuk janë në gjuhën shqipe të vertetuara me vertetim përthimi siç parashikohet në DST*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Autoriteti kontraktor me shtojcën 8, FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT, 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, 2.3.e Kapaciteti teknik, ka kërkuar:

- e) 2.3 e) Operatori ekonomik ofertues për produktet: **Pluhur ABC 40%, Shkumë AFFF (6%), Gaz FM-200, CO2**, duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor: Katalogë/fragmente të katalogut ose skedat teknike të publikuara nën autoritetin e prodhuesit për produktet e lartpërmendura. Dokumentacioni i kërkuar për këtë pikë duhet të përmbajë karakteristikat teknike të specifikimeve teknike të kërkuara në DST me qëllim që autoriteti kontraktor verifikojë përputhshmërinë me përcaktimet e DST.

Shtojca 8 Kriteret e Përgjithshme të kualifikimit:

- 1. Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

III.4.2 Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një*

kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. 7 Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III4.3. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. 2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm

gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet. 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme, edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit

III.4.4 Në nenin 40, pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

III.4.5 . Në lidhje me pretendimet e ankimuesit “Mbrotjtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” SHPK mbi mospërmbushje të kriterit të mësipërm të operatorit ekonomik “I-Fire” shpk, konkretisht për mosplotësim të: **KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT** pika **2.3.e**

Operatori ekonomik “I-Fire” SHPK, ka depozituar në SPE dokumentet si vijon:

Vertetim Njesie me Origjinalin nr 20303 rep datë 30.09.2024 me objekt- Autorizim ne gjuhen angleze e perkthyer nga perkthyesi i licensuar Saimir Shefa bashkelidhur vertetim perkthimi me Nr ep 20302.

-Autorizim ne gjuhen angleze e perkthyer gjithashtu ne shqip ku citohet se : *Drejtuar nga: Qendra Spitalore Universitare Nene Tereza Tirane Për procedurën me Objektin e Prokurimit: "Riparimi dhe mirëmbajtja e sistemit hidro-mekanik-elektrik të MSH-së dhe rimbushja dhe*

kolaudimi i aparateve zjarrefikëse në godinat spitalore të QSUNT", për 24 muaj. Numri i tenderit: REF-20976-09-20-2024 Me të cilin Ne: AFMER Kimya A.Ş. Incorporated Co Kestel-Bursa/Turqi

Ne deklarojme se: "i-FIRE" shpk, me (NUIS) L71921002H , me adrese ne Tirane, "Rruga Kavajës", pallati me shigjeta, Dyqani nr. 9, furnizohet nga ne për materialet që prodhojme: pluhur (40%) dhe shkumë (6%), dioksid karboni (CO 2), FM-200 (HFC 227ea). Si prodhues i autorizuar i ketyre produkteve, ne deklarojmë se subjekti "I-Fire" shpk është klienti ynë. Kjo deklaratë jepet për procedurën objekt prokurimi: siroemit hidro-mekanih-elektrik te MSH-se dhe rimbushja dhe kolaudimi i aparateve zjarrotheran e godinat spitalore të QSUNT", për 24 REF-20976-09-20-2024 për autoritetin kontraktor: Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza Tiranë.

Ps. Ky autorizim mbetet i vlefshëm edhe në rast te ndryshimit të datës se tenderit

-Vertetim përkthimi me nr rep 20302 datë 30.09.2024

-Kërkesë për sqarim nga përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor drejtuar operatorit ekonomik "I-Fire" SHPK me përmbajte "Në kuadër të ankesës së ardhur në sistemin Kpp.al me nr.A/2024/4707, date 2024-10-24 dhe me nr. 3096/2024 prot. për procedurën "Riparim mirëmbajtje e sistemit hidro-mekaniko-elektrik dhe rimbushje e kolaudimin e fikëseve të zjarrit në godinat spitalore te QSUNT", për 2 muaj kërkojmë nga ana juaj sqarim përsa i përket skedave teknike për artikujt e mëposhtëm:

- 1. "Pluhur ABC" skeda teknike i korrespondon shoqërisë ECOCHMMACH JSC*
- 2. "FM-200" skeda teknike i korrespondon shoqërisë INNER MONGOLIA YOUNGHE FLUOROCHEMICAL CO LTD*

Të dy këto artikuj kanë origjinë të ndryshme nga prodhuesi që ju keni paraqitur autorizim "AFMER KIMYA A.S Incorporated CO.

-Kthim përgjigje në formë komunikimi elektronik , nga operatori ekonomik "I-Fire" shpk drejtuar përfaqësuesit të Autoritetit Kontraktor me përmbajte "Pershëndetje , Duke iu referuar kerkeses suaj per sqarim ne lidhje me skedat teknike te artrame "Pluhur ABC" dhe "FM-200" , skedat teknike de ne kemi paraqitur janë skedals tertA cilat na i ka ofruar kompania : "Afmer Kimya" prej të cilës ne blejme dhe keto produkte . Ketë gje mund ta vërtetojmë dhe nepermjet deklarates që kompania Afmer Kimya ka bërë, ku ka shpjeguar dhe specifikisht arsyen pse keto skeda i perkasin shoqerive të tjera. Bashkëlidhur gjeni dhe deklaratën" Bashkelidhur Deklarate PDF.

-Deklaratë lëshuar nga Afmer Kimya lëshuar ne gjuhen angleze përkthyer ne shqip me përmbajte deklarate " Ne importojme produkte Pluhur dhe FM-200 nga kompani të tjera si lënde te para dhe me pas i shesim ato nën logon dhe paketimin e kompanisë sonë. Fletët e te dhenave teknike te pluhurit qe korrespondon me kompanine: "ECOCHMMACH JSC" dhe te FM-200 që korrespondon me kompanine "INNER MONGOLIA YOUNGHE FLUOROCHEMICAL CO LTD" jane fletët e te dhënave teknike te paraqitura nga prodhuesi i lendes se pare per letë arsye fletegt e te dhënave teknike korrespondojnë me kompani te tjera dhe jo me kompaninë tone.

Keto flete te dhëna teknike te prodhuesce janë paraqitur nga kompania jone per cdo shitje qe ne kemi bere te ketyre 2 produkteve.

Këto produkte kur vijnë te distributori jone i autorizuar "i-Fire" Shpk vijnë te paketuara nen logon tone "Afmer Kimya". Nenshkruar dhe vulosur nga drejtori i përgjithshëm i kompanisë.

Përkthimi i Vulosur dhe nënshkruar nga perkthyesi zyrtar Saimir Shefa.

-Vertetim përkthimi me nr 24734 datë 25.11.2024

-Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor ku dërgon një komunikim elektronik e-mail Afmer Kimya mbi një kerkese per sqarim ne gjuhen angleze.

-Kthim pergjigje nga Kompania Afmer Kimya ne gjuhen angleze ne forme komunikimi elektronik email ndaj përfaqësuesit te autotiteit kontraktor.

-Vertetim njësie me origjinalin Nr rep 20199 datë 30.09.2024 me permbatje “ Flete e te dhënave te sigurisë Materiae FM-200 ne gjuhen angeleze përkthyer nga përkthyesi i licensuar Saimir Shefa bashkëlidhur vërtetim përkthimi me nr repertori 20198

-Flete e te dhënave te sigurisë ne gjuhen angleze dhe e pekthyer ne shqip, lëshuar nga Inner Mongolia Yonghe Flurochemical Co LTD per Heptafuopropan R227ea (FM-200)

-Vertetim perkthimi Nr 20198 rep dhe date 30.09.2024.

-Flete Zhdoganimi per produktin preparat dhe ngarkesat per zjarrfikset ngarkesat per granadat Preparat Powder per fiksje zjarri ne thasë ardhur nga Afmer Kimya ne emër te marrësit I-Fire

-Fature Financiare datë 03.10.2023 . Pra sic vërehet qartë operatori ekonomik lidhur me kriterin e kërkuar dhe mbi pretendimet e operatorit ekonomik animues ka dorezur dokumentacionin e nevojshëm për përmbushjen e pikës 2.3.e të përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit në të cilin vete kompania Afmer Kimya pra kopania qe ka lëshuar autorizim prodhuesin ka cituar se skedat teknike te ngarkuara nga “I-FIRE” shpk dhe pse i përkasin një kompanie tjetër te cilës sipas tyre eshte kompania (Mëmë) me saktë citon se “*Ne importojme produkte Pluhur dhe FM-200 nga kompani të tjera si lënde te para dhe me pas i shesim ato nën logon dhe paketimin e kompanisë sonë. Fletët e te dhenave teknike te pluhurit qe korrespondon me kompanine: "ECOCHMMACH JSC" dhe te FM-200 që korrespondon me kompanine"INNER MONGOLIA YOUNGHE FLUOROCHEMICAL CO LTD" jane fletët e te dhënave teknike te paraqitura nga prodhuesi i lendes se pare per këtë arsye fletet e te dhënave teknike korrespondojnë me kompani te tjera dhe jo me kompaninë tone.*

Keto flete te dhëna teknike te prodhuese janë paraqitur nga kompania jone per cdo shitje qe ne kemi bere te ketyre 2 produkteve.

Këto produkte kur vijnë te distributori jone i autorizuar “i-Fire” shpk vijnë te paketuara nen logon tone “Afmer Kimya”. Nenshkruar dhe vulosur nga drejtori i përgjithshëm i kompanisë.

III.4.6 KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti 12 kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron

kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

Komisioni referuar dokumenteve të dosjes vëren, se operatori ekonomik "I-Fire" SHPK referuar sa më sipër ku operatori ekonomik pretendon se *"Të gjitha katalogjet/skeda teknike te produkteve nuk janë në gjuhën shqipe të vërtetuara me vërtetim përkthimi siç parashikohet ne DST"* Komisioni Prokurimit Publik vëren se Operatori ekonomik "I-Fire" shpk ka dorëzuar dokumentacionin si më sipërcituar, dhe nga verifikimi i tyre konstatohet nga ana e Komisionit Prokurimit Publik referuar dokumenteve të operatorit ekonomik referuar pretendimit të operatorit ekonomik ankimues operatori ekonomik "I-Fire" shpk ka përmbushur kriterin duke ngarkuar në sistem dokumentacionin e përkthyer dhe sa më sipër, Komisioni gjykon se operatori ekonomik "I-Fire" shpk me dokumentacionin e dorëzuar plotëson kërkesën e përcaktuar në funksion të tij.

III.5 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Mbrojtja dhe shpëtimi nga Zjarri" shpk me pretendimin për mospërmbushjen e kriterit nga operatorit ekonomik "I-Fire" shpk se *"-Autoriteti kontraktor duhet të vlerësojë saktë mbi keto katalogje/skeda teknike nese jane ne formen e duhur apo perputhen me specifikimet teknike te vendosura prej tij"*,
- Duke patur parasysh se ky operator ekonomik ne formularin permbledhes te vetedeklarimit nuk i pasqyron te gjithe anetaret e organit administrative, theksojme se ortaku i kesaj shoqerie eshte i ndryshem nga administrator dhe si i tille duhej te vendosej ne formularin permbledhes te vetedeklarimit.. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.5.1. Në ankesën drejtuar pranë autoritetit kontraktor dhe pranë KPP, operatori ekonomik ankimues nuk parashtron fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime *a-priori*, duke ngritur dyshime e hamendësime, lidhur me plotësimin e specifikimeve teknike apo kriterëve nga operatori ekonomikë "I-Fire" SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

III.5.2. Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021, *"Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale, duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe "elementet e domosdoshme të ankesës", sipas përcaktimeve të nenit 48, "Kushtet formale të ankesës", pika 3:

- *Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni".*

III.5.3. Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon, se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicie dhe argumente ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej kjo ankesë. Vlen të ritheksojmë, se Komisioni i

Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 90 të LPP dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

III.5.4. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatorëve të tjerë ekonomikë. Theksojmë se mospërbushja e kriterit apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërbushje kriteri/kritereve.

III.5.5. Komisioni i Prokurimit Publik thekson dallimin e qartë – në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikusht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe pretendimit/prendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesëmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër.

III.5.6. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe në kuptim të misionit të tij për të siguruar efikasitetin e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson, se duhet të adoptojë një qëndrim *pro-aktiv*, në krah të operatorit ankimes. Në rastin e dytë, kur operatori pjesëmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion *re-aktiv*, në pritje të argumenteve të plota provuese, se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimesit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është në drejtë të operatorëve ekonomikë, të paraqesin pretendime mbi kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës së operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke justifikuar kështu interesin e tyre të ligjshëm, por ndërkohë, operatorët ekonomikë nuk mund të parashtrajnë pretendime a-priori, duke mos identifikuar asnjë element konkret brenda kritereve të veçanta të kualifikimit, si edhe duke mos dhënë asnjë provë apo argument se ku i mbështesin pretendimet e tyre.

Vetë Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar në nenin 82 pika 1 të tij se “*Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj*”.

Një ndër parimet kryesore të së drejtës është ai se “*onus probandi incumbit actori*”, barra e provës bie mbi ankuesin. Gjithashtu, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar të gjitha elementet procedurale, përmes të cilave garantohet e drejta e informimit të operatorëve ekonomikë në kuadër të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik.

III.5.7. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementeve përbërëse të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar përpara tij ose të barabartë me të në ofertë ekonomike, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cenon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

III.5.8. KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si e tillë në vendimmarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik, i cili thekson faktin, se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe

provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit, e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk merren në shqyrtim.

III.6 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Mbrotja dhe Shpëtimi nga Zjarri” shpk mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “I-Fire” shpk me pretendimin se: *Duke qene se asnje nga pikat me siper nuk eshte dorezuar dokumentacion provues per te gjithë anetaret e organit administrative, autoriteti kontraktor do te duhej qe ta skualifikonte kete operator ekonomik.*” Komisioni Prokurimit Publik veren se :

III.6.1 Në shtojcën 9 është parashikuar “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt – ankim.

III.6.2 Referuar dokumentacionit të autoritetit kontraktor ne SPE ashtu dhe të administruar pranë KPP-së, operatori ekonomik “I-Fire” shpk, në përmbushje të këtij kriteri, operatori ekonomik ka paraqitur

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ku citon: si administrator F.XH dhe ortak N.M
- Vertetim i gjendjes gjyqesore lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me Nr 11 datë 23.09.2024 ku citohet se subjekti I-Fire” me NIPT L7192102H është i Padënuar
- Vertetim Nr. 11 lëshuar nga Ministria e Drejtësisë (Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve) kjo lëshuar me datë 31.07.2024 ku citohet se N.M është i padënuar.
- Vertetim Nr 11 lëshuar nga Ministria e Drejtësisë (Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve) kjo lëshuar me datë15.07.2024 ku citohet se F,XH është i padënuar.

III 6.3 Në nënin 82 te ligjit 162/2020 PËR PROKURIMIN PUBLIK, ligjvënësi ka parashikuar:
Neni 82

Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.

Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.

4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

5. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Rregulla të posaçme për këtë pikë parashikohen në rregullat e prokurimit publik.

III.6.4 Në nenin 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” përcaktohet se; Neni 26 Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit 1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve¹ të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

¹ Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike². Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime....”

III.6.5 Në nenin 77 pika 1 të ligjit 162/2020 të LPP-së përcaktohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III 6.6 Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të

² Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.6.7 Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Mbrojtja dhe Shpëtimi Nga Zjarri” shpk mbi operatorin ekonomik “I-Fire” shpk se *“gjithashtu per pikat me siper duhej te dorezohej dokumentacion provues. Dukeqene se asnje nga pikat me siper nuk eshte dorezuar dokumentacion provues per te gjitha anetaret e organit administrative, autoriteti kontraktor do te duhej qe ta skualifikonte kete operator ekonomik..”* Referuar sa më sipër, nga verifikimet e kryera nga dokumentacioni i administruar pranë autoritetit kontraktor, të operatorit ekonomik konstatohet, se “I-Fire” shpk, ka dorëzuar për Shtojcën 9, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, nga shqyrtimi i të cilit rezulton, se në pjesën e parë të tij është dhënë informacioni në lidhje me ortakun, administratorin, gjithashtu referuar QKB Administratori/ët Fation Xhelilaj 10.1 Afati i emërimit Nga: 17/06/2021 deri: 17/06/2026 dhe Ortakët Neldar Malkaj , dhe referuar formularit operatorit ekonomik ankimues ka plotësuar seksionin Pjesa e II Shkaqet e Perjashtimit Deklarata.

Referuar formularit, i cili është një provë paraprake mbi kërkesat të cilat ky formular përmban, në rastin konkret ndodhemi para faktit ku operatorit ekonomik i kualifikuar i pari dorëzon pranë Autoritetit Kontraktor dokumentacionin provues lidhur me Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas ligjit për Prokurimin Publik 162/2020, përkatësisht nenit 82, pikës 5. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë:a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre;b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Referuar Formularit të Vetëdeklarimit , “I-Fire” shpk, (pjesë e ofertës së dokumentacionit të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor rezulton se subjekti “I-Fire” shpk ka dorëzuar dokumentacionin shkresor si me poshtë : Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ku citon si administrator F.XH dhe ortak N.M.

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ku citon: si administrator F.XH dhe ortak N.M
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Bugjeve me Nr. 11 datë 23.09.2024 ku citohet se subjekti “I-Fire” me NIPT L7192102H është i padënuar.
- Vërtetim Nr. 11 lëshuar nga Ministria e Drejtësisë (Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve) kjo lëshuar me datë 31.07.2024 ku citohet se N.M është i padënuar.
- Vërtetim Nr. 11 lëshuar nga Ministria e Drejtësisë (Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve) kjo lëshuar me datë15.07.2024 ku citohet se F.XH është i padënuar.

III.6.8 Referuar sa më sipër në lidhje me formularin e vetëdeklarimit të shoqërisë “I-Fire” shpk, Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se lidhur me pretendimin se nuk është dorëzuar dokumentacioni i duhur për ortakët dhe administratorët, referuar pikës 3 të nenit 26 citon ***“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike³. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.***

³ Ndryshuar me Vendimin Nr. 710 datë 24.11.2021

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike” Sikurse është parashikuar në nenin 26 pika 3 e VKM në asnjë moment operatori ekonomik i shpallur fitues nuk ka detyrimin të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor dokumentacionin që lidhet me pikën c të pikës 26 të VKM 285 datë 19.05.2021, për të cilën ka pretendim skualifikimi. Autoriteti Kontraktor pranon dokumentacionin sipas pikave të përcaktuara në nenin 26. Pra lidhur me dokumentacionin për të cilën operatori ekonomik ka dorëzuar, ku i përket ortakut të kësaj kompanie dhe administratorit, theksojmë se nuk ka detyrim operatori ekonomik të sjellë në funksion të Formularit të Vetedeklarimit.

Gjithashtu theksojmë se legjislacioni i prokurimit publik i njeh të drejtën autoritetit kontraktor, të verifikimit apo sqarimit nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, lidhur me vërtetësinë dhe saktësinë e informacionit që përmbajnë dokumentet e paraqitura.

Vendosja e kriterëve të kualifikimit ka si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Mbrotjtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” shpk, nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Mbrotjtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” shpk, në procedurën e prokurimit ““E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-

20976-09-20-2024, me objekt: “Riparim mirëmbajtje e sistemit hidro-mekaniko-elektrik të MZSH dhe rimbushje e kolaudimin e fikësve të zjarrit në godinat spitalore të QSUNT”, për 24 muaj me fond limit 7,106,366.67 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 03-10-2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore Universitare Nene Tereza Tirane.

2. Autoriteti kontraktor të vijojë më hapat procedural të procedurës objekt ankimi.
3. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë derdhjen në Buxhet të Shtetit të tarifës të paguar nga operatori ekonomik “Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” shpk.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro